



## Thirrje publike për aplikim në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin “Travel News Market”

27 nëntor 2025

Adresa: Stokholm, Suedi

### Hyrje

Me qëllim të promovimit të potencialeve turistike të Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset e sektorit të turizmit të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtarë.

Ky aktivitet organizohet nga KIESA në koordinim dhe bashkëpunim me projektin FEGO – Swisscontact. FEGO mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese dhe shtandit për pjesëmarrjen maksimumi deri të 10 bizneseve (operatorë turistik, agjencione turistike dhe hotele). Angazhimi i konsulencës për arranzhimin e takimeve B2B, parapërgatitjes së bizneseve pjesëmarrëse për prezantim në panair, dhe promovimi i ofertës në kanalet zyrtare të komunikimit të panairit do të mbulohen nga projekti nga projekti FEGO – Swisscontact. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese etj., të bizneseve pjesëmarrëse do të mbulohen nga vet bizneset.

Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 08.10.2025. Dokumentet e plotësuar si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar me të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Dëshminë e xhirrollogarisë aktive në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;
7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2024 nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK); dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK-së, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

**Shënim:** Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme, aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet.

**Kriteret e vlerësimit:**

- Produktet turistike inbound që do të ju ofrohen turistëve në panair, maksimum 10 pikë:
  - 1 pikë për 1 produkt turistik inbound
  - 3 pikë për 2 produkte turistike inbound
  - 5 pikë për 3 produkte turistike inbound
  - 7 pikë për 4 produkte turistike inbound
  - 10 pikë për 5 e më shumë produkte turistike inbound
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
  - Gjuhë Angleze 5 pikë
  - Gjuhë Suedeze 4 pikë dhe
  - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
  - Gjuhë Angleze 4 pikë
  - Gjuhë Suedeze 4 pikë dhe
  - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Aktiviteti primar turistik i subjektit aplikues, maksimum 10 pikë:
  - Tour operatorë 8 pikë
  - Agjenci turistike 4 pikë
  - Hotele 2 pikë

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashke me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 08.10.2025 në e-mail adresën: [Export.Kiesa@rks-gov.net](mailto:Export.Kiesa@rks-gov.net)

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informatat dhe dokumentet e kërkuara për aplikim mund të merren në KIESA-MINT, apo të shkarkohen nga faqet e internetit:

⇒ [mint.rks-gov.net](http://mint.rks-gov.net) dhe [kiesa.rks-gov.net](http://kiesa.rks-gov.net) apo në e-mail adresën:

⇒ [Export.Kiesa@rks-gov.net](mailto:Export.Kiesa@rks-gov.net)

**Shënim:** Më 25.09.2025, në ora 9:30, në sallën e takimeve në KIESA, organizohet sesioni informues, ku KIESA dhe projekti FEGO – Swisscontact do të ju njoftojnë më në detaje për aktivitetin dhe do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive mbi përfaqësimin në këtë panair.